



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 177/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Ferizaj, paraqitur kundër Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Ferizaj, për shkak të vendosjes së posterave brenda hapësirës së stacionit të autobusëve, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 09.10.2013, mori këtë:

VENDIM

Miratohet si e bazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Ferizaj, kështu që Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 800 (tetëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Arsyetim

Me datën 06.10.2013, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik PDK, në të cilën theksohet se me datën 06.10.2013, në Rrugën “Ahmet Kaçiku”, LVV, ka vendosur posterin e kandidatit për kryetar komune, në hapësirat (brenda) stacionit të autobusëve, ku me këtë veprim sipas parashtruesit të ankesës janë shkelur dispozitat ligjore mbi zgjedhjet lokale, Kodin etik të subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre, si dhe Rregullën ligjore Nr. 01/2012, neni 3 alineja 3.2 të kësaj rregulloreje.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si provë fotografi si dëshmi.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik LVV, me datën 07.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 08.10.2013. Sipas afatit të caktuar PZAP-i, pranoi përgjigjen në ankesë nga LVV, në të cilën theksohet se në asnjë rast LVV, nuk ka vendosur posterë brenda hapësirës së stacionit të autobusëve, dhe se pretendimi i PDK-së, është tendencioz dhe i inskenuar, ngase fotot të cilat i ka dërguar subjekti politik PDK, me datë 6.10.2013, janë në hapësirën ku aktivistë të LVV, kanë vendosur posterë në një kioskë që gjendet në afërsi të stacionit të autobusëve, objekt ky i cili sipas LVV-së, është privat dhe i pashfrytëzuar momentalisht, dhe në përputhje me nenin 3.5 të Rregullës Zgjedhore 13/2013. Bashkangjitur më përgjigjen në ankesë LVV, ka dërguar fotot për të cilat thuhet se përputhen me fotot e dërguara nga PDK, e të cilat qëllimisht subjekti në fjalë i ka bërë vetëm nga afër, dhe se ky pretendimi PDK-së është i papranueshëm dhe në kundërshtim me të gjitha rregullat zgjedhore duke abuzuar me të drejtën e ankesës, për shkak të paraqitjes së rrejshme, thuhet mes tjerash në përgjigjen në ankesë nga LVV.

Përgjigjes në ankesë i janë bashkangjitur udhëzuesi i përgatitur për anëtarët e LVV-së të cilët janë të angazhuar gjatë fushatës zgjedhore me të cilin ju kërkon që të respektohen rregullat zgjedhore dhe po ashtu ka bashkangjitur fotografi në të cilat shihet qartë, mbështetësi i LVV-së, duke e larguar posterin nga vendi ku ishte pretenduar në ankesë se ka qenë i vendosur posteri.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Sipas parashtruesit të ankesës, LVV, ka vendosur posterin e kandidatit të tyre për Kryetar të Komunës, në hapësirën brenda stacionit të autobusëve, i cili veprim është në kundërshtim me nenin 33 pika b) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme LZP, nenin 4.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore Nr.11/2013, të cilat përcaktojnë veprimet e ndaluara të subjekteve politik, që kanë të bëjnë me vendosjen e njoftimeve, pllakateve dhe postereve, ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugë publike, në shenja publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave, ose ndërtesave të zëna, në lidhje me fushatën zgjedhore, nga ana e subjekteve politike.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Nga fotografitë e ofruara si provë, nga parashtruesi i ankesës, të bashkangjitura shkresës së lëndës, shihet qartë se posteri i kandidatit për kryetar komune nga radhët e LVV-së, është i vendosur në kioskë në hapësirën e stacionit të autobusëve, që konsiderohet hapësirë publike të cilin veprim PZAP-i, konstaton se është në kundërshtim me dispozitat ligjore të lartcekura.

PZAP-i, mori parasysh të gjitha rrethanat si rënduese ashtu edhe rrethanat lehtësuese. Si rrethanë rënduese mori se LVV, ka marr pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se konsiderohet se është e njoftuar me procesin zgjedhor dhe faktin se posterat e kandidatit për kryetar komune në Ferizaj kanë qenë të vendosur në vendin e palejuar për vendosjen e posterave. Ndërsa si rrethanë lehtësuese PZAP-i, mori se LVV, pas marrjes së kërkesës për përgjigjes në ankesë nga PZAP-i, brenda afatit të caktuar, ka ndërmarr veprime të dukshme për evitimin e shkeljes, duke i larguar menjëherë fotografit nga vendi ku pretendohet se ka ndodhur shkelja e supozuar.

Andaj PZAP-i duke marr parasysh të gjitha arsyet e lartcekura se nga ana e LVV-së është shkelur nenin 4 paragrafi 1 pika "b" të Rregullës Zgjedhore 13/2013 të KQZ-së dhe nenin 33 pika b) të LZP-së, pasi që posterat e kandidatit për kryetar të komunës të LVV-së janë vendosur brenda hapësirës publike, si dhe duke pasur parasysh veprimet e menjëhershme të subjektit politik LVV-së, për evitimin e shkeljes së supozuar si dhe përpjekjet për të parandaluar veprimet e ndaluara në bazë të provave të cilat i ka ofruar të bashkangjitura përgjigjes në ankesë të cilat veprime kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptua, në kuptim të nenit 3.2 të Rregullës 01/2012 të PZAP-it, nenit 120 paragrafi 1 pika c), si dhe nenit 115.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në Prishtinë

Anr. 177/2013 më datën 09.10.2013.

**Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha**



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*